



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANCAVE



Buxheti i Qytetarit 2016

STRUKTURA

Merr pjesë - Transformo jetën tënde	05
Parimet mbi të cilat mbështetet buxheti	06
Fazat e procesit buxhetor	07
Transparenca ndaj qytetarit	08
Objektivat Makroekonomike 2016	09
Nga vijnë paratë e buxhetit?	10
Ku do të përdoren taksat	11
Buxheti dhe borxhi	12
Arsimi	13
Shëndetësia	14
Mirëqënia dhe kohezioni social	15
Mbështetje për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik	16
Bujqësia	17
Infrastruktura	18
Për një pjesëmarrje cilësore	19

Mesazh për lexuesin



Në vitin 2016, Qeveria juaj do të shpenzojë 452.1 miliardë lekë. Me fjalë të tjera, rreth 156 mijë lekë për çdo burrë, grua dhe fëmijë në vendin tonë; rreth 1.24 miliardë lekë në ditë ose rreth 863 mijë lekë në minutë. Buxheti i vitit 2016 është buxheti i zhvillimit rajonal, i thellimit të reformave dhe i uljes së borxheve dhe taksave. Shumica e këtyre parave vijnë nga taksapaguesit shqiptarë.

Qeveria i shpenzon këto para për një sërë aspektesh – nga programet e mëdha siç janë Sigurimet Shoqërore, Ndihma Ekonomike, Arsimi, Shëndetësia, e deri tek aktivitetet e vogla dhe të padëgjua siç mund të jetë riparimi i një zyre apo blerje kancelarie. Së bashku, këto programe përbëjnë atë që quhet Buxheti i Shtetit.

Sa dini ju për buxhetin e shtetit? Nëse përgjigja juaj është “jo shumë”, Ju nuk jeni të vetmit. Në fakt, pothuajse askush nuk di gjithçka që shkruhet në faqet, tabelat dhe kapitujt e shumtë që përbëjnë buxhetin e shtetit të çdo viti. Por, ne e dimë që juve ju intereson shumë fakti sesi Qeveria i shpenzon paratë tuaja. Për këtë arsye kemi krijuar këtë guidë të Buxhetit për Qytetarët. Përmes këtij edicioni të parë të saj, i cili do të ndiqet periodikisht nga shumë të tjerë, ne shpresojmë ta bëjmë buxhetin më të kuptueshëm dhe të përdorshëm nga të gjithë.

Ky dokument është dizenuar në mënyrë të tillë që të mund t’ju ofrojë një lloj “udhëtimi” përmes buxhetit të shtetit. Në faqet e tij ne do të sqarojmë për Ju sesi Qeveria i krijon të ardhurat dhe sesi ajo i shpenzon paratë e saj, sesi Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi e miraton buxhetin, sesi vendi përballon sfidatë tilla si: ulja e defiçitit buxhetor apo menaxhimi i borxhit publik, dhe se çfarë Qeveria synon të arrijë me këtë buxhet gjatë vitit 2016. Pasi të lexoni këto faqe, ne shpresojmë të mendoni se koha që harxhuat për të ia vlejti.

Duke ju uruar lexim të këndshëm, vëmë në vëmendjen tuaj se dokumenti i Buxhetit për Qytetarët dhe dokumente të tjera më teknike e analitike mbi Buxhetin e Shtetit për vitin 2016, do të mund t’i gjeni edhe në formë elektronike, të publikuara në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave (www.financa.gov.al) ose të Kryeministrisë (www.kryeministria.al).

Singerisht,
Shkëlqim Cani
Ministri i Financave

Merr Pjesë

Transformo Jetën tënde!

Përfshirja juaj në çdo hap të këtij buxheti, nënkupton rritje të efikasitetit dhe efikasitetit të përdorimit të të ardhurave buxhetore në funksion të një jetë më të mirë për ju dhe brezat e ardhshëm.



Parimet mbi të cilat mbështetet buxheti



> Disiplinë fiskale, e cila ndihmon në ulje të borxhit publik duke garantuar më pak barrë fiskale për brezat që vijnë.

01



> Shpërndarje të burimeve në përputhje me objektivat strategjike të vendit.

02



> Përdorim eficient i të mirave publike në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

03



> Menaxhim më i mirë për të bërë të mundur rritjen e të ardhurave, uljen e informalitetit dhe nivelit të korrupsionit.

04



> Respektim i parimeve, kriterëve dhe afateve në çdo hallkë të buxhetit.

05

FAZAT E PROÇESIT BUXHETOR

Për një pjesëmarrje aktive

PLANIFIKIMI

- Udhëzim për përgatitjen e buxhetit dhe parashikimet buxhetore
- Projekti i programit buxhetor
- Publikimi i buxhetit dhe programit vjetor
- Kalendari i menaxhimit të shpenzimeve publike
- Udhëzim plotësues për përgatitjen e buxhetit
- Projekt Buxheti Vjetor

KONTROLLI

- Kontabiliteti dhe raporti
- Raporti vjetor i zbatimit
- Miratimi i raportit vjetor dhe publikimi
- Raportet e zbatimit të buxhetit
- Kontrolli i brendshëm financiar publik
- Auditimi i brendshëm
- Inspektimi financiar
- Auditimi i jashtëm

ZBATIMI

- Udhëzim për zbatimin e buxhetit
- Shpërndarja e fondeve buxhetore
- Rishikimi i fondeve buxhetore
- Mbyllja e buxhetit

MIRATIMI

- Këshilli i ministrave dërgon për miratimin në kuvend
- Diskutohet, bëhen ndryshimet e nevojshme dhe miratohet
- Përgatiten dhe miratohen buxhetet vendore
- Botohet në fletoren zyrtare

Transparenca ndaj qytetarit

Redukton abuzimet dhe korrupsionin

Studimet dhe eksperiencat kanë vërtetuar se vendet që ofrojnë informacion të mjaftueshëm buxhetor kanë tendencë të kenë:

- 1 nivel të ardhurash më të larta,
- 2 media të lirë,
- 3 sistem demokracie të konsoliduar
- 4 praktikisht më pak korrupsion.

Buxheti i qytetarëve si burim transparence synon:

- 1 më shumë informacion të publikuar,
- 2 më shumë mundësi për pjesëmarrje të publikut,
- 3 fuqizim të institucioneve mbikëqyrëse
- 4 promovim e zhvillim të një sistemi të integruar buxhetor në tërësi.



Objektivat Makroekonomike 2016



Rritja ekonomike 3.4% ose 0.7 pikë % më shumë se parashikimi i vitit 2015.

Prodhimi i Brendshëm Bruto
1530,4 mld lekë
12.2 mld USD
11.1 mld Euro

Huamarrja totale neto do të ulet në 2.8% e PBB-së.



Inflacioni parashikohet 2.5% nga 2.1% që ishte në vitin 2015.

Të ardhurat për frymë
527.7 mijë lekë
4206 USD
3827 Euro



Borxhi publik në vitin 2016 parashikohet të ulet në 71.3% nga 72.2% në vitin 2015.

Norma e papunësisë parashikohet -1.3 pikë %.

Papunësia zbret në 15.5% nga 16.8% në 2015.



Investimet publike do të jenë rreth 5% e PBB-së (përfshirë fondin e rajoneve)



Bilanci tregtar 2016 parashikohet -17.4% e PBB-së.

Nga vijnë paratë e buxhetit?

Burimet kryesore të të ardhurave për vitin 2016 pritet të jenë në zërin “Të ardhura nga Tatimet dhe Doganat”, me 67.8% e totalit të të ardhurave:

Kontributi në rritjen prej 4.9% krahasuar me vitin 2015 vjen si rrjedhojë e:


- Mirëadministrimi + 2,5 mld lekë.
- Lufta ndaj informalitetit + 8.9 mld lekë.
- Efektet e politikave fiskale + 1,44 mld lekë,
- Kudri makroekonomik + 5,9 mld lekë
- Të ardhurat nga faktorë të tjerë + 2 mld lekë



Ku do të përdoren taksat?

Pjesëmarrje aktive në çdo fazë të buxhetimit të politikave dhe projekteve prioritare

Shpenzimet sipas funksioneve 2016




Buxheti dhe borxhi


Në buxhetin e vitit 2016 borxhi publik do të reduktohet në 71.3% e PBB-së nga 72.2% që ishte në vitin 2015.

Borxhi për frymë në vitin 2016 është 374.8 mijë lekë nga 358.9 mijë lekë që ishte në 2015

Deficiti Buxhetor ulet me 0,7 mijë lekë për frymë në vitin 2016 krahasuar me vitin 2015



Arsimi



13 e fëmijëve 5 vjeçarë në një vit shkollor

Shëndetësia

Për çdo shqiptar në vitin 2016 parashikohen të shpenzohen 15,210 lekë për kujdesin shëndetësor nga 15,220 lekë që shpenzoheshin në vitin 2015

Kontroll mjekësor periodik për 868.000 persona të moshës 40-65 vjeç

Zgjerimi i skemës së medikamenteve nga 485 në vitin 2015 në 500 në vitin 2016

Trajnim i personelit për 1.700 mjekë dhe 6600 infermjerë

Plotësim i qendrave shëndetësore 100% me infrastrukturë për funksionimin e sistemit të informacionit

Funksionimi i shërbimit të urgjencës kardiake dhe vaskulare cerebrale 24/7 nga ku do të përfitojnë rreth 4000 persona

Pajisje për laboratorët e poliklinikave nr.2 dhe nr.3 në Tiranë dhe në poliklinikën e Korçës

Nga partneriteti publik - privat do mundësohet shërbim të hemodializës në spitalet rajonale në Vlorë, Korçë, Lezhë

Njësitë e lëvizshme të mamografisë do të vijojnë të ofrojnë kontolle parandaluese pa pagesë në zona të largëta të vendit për 600 gra

Pajisje të reja në qendrën kombëtare të traumës për 40 mijë pacient në vit si dhe 4000 operacione kirurgjikale që realizohen në vit



Mirëqënia dhe Kohezioni Social

+ 2% rritja e përfitimeve mesatarisht në masën e pensioneve nga Korrik 2016
+ 3000 familje jashtë ndihmës ekonomike – rritje punësimi.

Mbështetja me shërbime të përkujdesit social rezidencial dhe komunitar me

- + 370 fëmijë në nevojë, ose 8% më shumë
- + 380 fëmijë me AK, ose 10 % më shumë.
- + 7% më shumë e viktimave të trafikimit ,
- + 15% më shumë viktime të dhunës në familje
- + 440 të moshuar në nevojë

Përfshirja dhe mbulimi më i mirë do tju shërbej:

149 000 personave me aftësi të kufizuara dhe 23 000 kujdestarëve në programet e mbrotjes sociale.



Mbështetje për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik

Nxitje për hapjen e 13,000 bizneseve të reja dhe dhënia e 3,700 licensave;

Kreditim me kushte lehtësuese të 25 bizneseve dhe 4 trainimeve për ta;

Ndërkombëtarizimi i bizneseve shqiptare nëpërmjet granteve për 20 kompani eksportuese;

Mbështetje e mbi 110 bizneseve të udhëhequra nga gratë, nëpërmjet kredive të buta, deri në 50%;

Rritja e fluksit të Investimeve të Huaja Direkte nëpërmjet dhënies së shërbimeve ndaj 15 investitorëve të huaj, 4 studimeve për potencialet investuese e eksportuese si dhe dhënien e 8 konçensioneve.

Mbështetje e 470 bizneseve kreative, sidomos ato në fushën e artizanatit me grante

Mbështetje e rreth 300 bizneseve të reja (start up)





Bujqësia

Kullim i 22 000 ha. tokë bujqësore më shumë në krahasim me vitin 2015;

Vaditje 16 000 ha tokë bujqësore më shumë, në krahasim me vitin 2015;

35 km argjinatura të rehabilituara/ndërtuara/mirëmbajtura më shumë, në krahasim me vitin 2015;

28 hidrovore për kullim me pompa me sistem ngritje mekanike për të siguruar shërbim të sigurt dhe të qëndrueshëm për 75,000 ha. tokë bujqësore;

Mbështetje financiare për 12,000 fermerë që synojnë nxitjen e prodhimit bujqësor e blegtoral vendas, si dhe lehtësimin e daljes në treg;

Do të përmirësohet efektiviteti i skemës së subvencionimit të fermerëve.

Infrastruktura

Rrugë

Vazhdimi i financimit të akteve prioritare ,
Aksin Plepa - Kavajë- Rrogozhinë, Aksin
Elbasan – Banjë, Aksin Berat - Buzuq –
Çorovodë, Unazën e re të Tiranës, Qafë
-Thanë- Lin- Pogradec

Dhënia me konçension për ndërtimin,
operimin, mirëmbajtjen, rehabilitimin e
autostradës Milot- Morinë.

Mirëmbajtje e rrugëve kombëtare dhe
rurale.

Ndërhyrja në 63 objekte Ujësjetllës –
Kanalizime ku përfitojnë 598,672
qytetarë.

Ujësjetllës Kanalizime

Përfundimi i sistemit të KUZ dhe ITUP në
zonën e Vellipojës (Faza e III-të)

Furnizimi me ujë i qytetit të Peshkopisë.

Kanalizimet e ujërave të përdorura në
qytetin e Bilishtit, financim i qeverisë
Austriake

Furnizimi me ujë dhe mbrojtja mjedisore e
liqenit të Shkodrës

Mbulimi nga të ardhurat i 100% i kostos së
operimit të 36 Ujësjetllësve. Reduktimi i

nivelet të ujit pa të ardhura në 45%;
Shërbimi i furnizimit me ujë në shkallë
vendi 18 orë/ditë;

-Menaxhimi i mbetjeve Urbane të Tiranës

-Përfundimi i sistemit të KUZ dhe zgjerimi
ITUP në Vlorë

-Projekti i ri i furnizimit me ujë Durrësit

-Furnizimi me ujë në zonën e Ornkumit.

-Kanalizimet e Ujërave të Zeza, Pogradec

Për një pjesëmarrje cilësore

1. **Profilizohuni** - studioni strategjitë kombëtare dhe sektoriale
2. **Koherencë** - studioni dhe mësoni nga eksperiencia ndërkombëtare
3. **Përmirësoni** - hartimin, zbatimin, auditimin dhe kontrollin e buxhetëve
4. **Cilësorë** - në përdorimin e të dhënave sa më të sakta dhe afatgjata
5. **Parandaloni** – abuzimet me fondet buxhetore
6. **“Djali” qëndron në detaje** -skanoni çdo program, projekt dhe buxhetim respektiv
7. **Sfidoni** - propozoni projekte alternative me efikasitet më të madhe. që kërkojnë më pak para nga taksat tuaja

Kontakt

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”; Nr.3, Tiranë

Tel: +355 4 223 0803

Fax:+355 4 222 8405

